

Rregullorja brenda strukturave pritëse komunitare

Hyrje « Ju urojmë mirseardhjen në strukturën tonë pritëse

Në Belgjikë, ndihma ndaj kërkuesve të azilit dhe disa kategorive të huajsh që janë në vështirësi jepet në formë materiale e jo financiare. Në të përfshihet banesa, vaktet, veshmbathja, ndihma mjekësore, sociale e psikologjike si dhe një ndihmesë ekonomike e përditshme. Përveç të tjerash keni të drejtën të kërkoni ndihmë në fushë juridike, kurse formimi si dhe mbështetje përmes një programi të posaçëm në rast rikthimi vullnetar në atdhe. Struktura pritëse merr përsipër të garantojë një pritje e ndihmë sociale në respekt të dinjitetit njerëzor.

Për të përfituar nga kjo ndihmesë materiale ju duhet të banoni në strukturën pritëse. Nëse dëshironi të largoheni prej saj dhe jeni njëkohësisht kërkues azili, do të ruani përsëri të drejtën tuaj për ndihmë mjekësore.

E drejta për pritje dhe ndihmë mjekësore nuk lidhen domosdoshmërisht me pajisjen tuaj me të drejtë qëndrimi në Belgjikë.

Kjo rregullore ka për detyrë të garantojë një jetë të qetë në komunitet dhe kushtet e sigurisë maksimale gjatë qëndrimit tuaj.

Ky dokument përshkruan:

1. të drejtat tuaja dhe mënyrën sesi mund t'i ushtroni ato ;
2. rregullat që duhet të respektoni në strukturën pritëse ;
3. procedurën e ndëshkimeve si pasojë të mangësive të rënda ndaj kësaj rregulloreje dhe procedurën e masave që merren për të garantuar dhe rivënë rregullin, sigurinë dhe qetësinë në strukturën pritëse ;
4. procedurën që duhet ndjekur në rast ankesash.

Tani do gjeni rregulloren e vlefshme në të gjitha qendrat e FEDASIL e plotësuar (kompletuar) me veçoritë e vlefshme në Petit Château (shënim : Kështjellë e Vogël).

Për të zbuluar-gjetur funksionimin e qendrës sonë u ftojme të shikoni oraret e hapjes të secilit shërbim (të shënuara në dyert e tyre) si dhe rregulloren e shërbimit nëse kanë. Ju duhet gjithashtu të respektoni udhëzimet e dhëna nga personeli i shërbimit (Hyrja-Qasja për takim, respektimi i takimeve të bëra...).

I. Cilat janë të drejta tuaja dhe si mund t'i ushtroni ato?

I.1. Nevoja elementare

Struktura pritëse ju siguron ushqimin dhe prodhimet e nevojshme për higjienën personale. Sipas mundësive, mund t'ju garantohet edhe veshmbathja.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château) lidhur me shujtën (vaktin) :

Nëse jetoni në një dhomë pa kuzhinë, mund të shkoni për të ngrënë në restorant. Nuk lejohet (ndalohet) nxjerrja (dalja) e ushqimit si dhe pajisjeve nga restoranti.

Kërkojmë nga anëtarët e familjeve të paraqiten së bashku (tok) për shujtë (vakt), përveç nëse fëmijët kanë në shkollë apo nëse njëri nga anëtarët e familjes nuk gjendet në Qendër për shkak të procedurës. Nëse duhet, për çfarëdo të jetë arsyeja, të mungoni gjatë shujtës (vaktit), mund të kërkonit një drekë për t'a marrë me vete. Për më shumë informata drejtoheni tek shoqëruesi juaj social.

Nëse keni dhomë me kuzhinë, nuk keni qasje në restorant.

I.2. Ndhimja dhe shoqërimi social

Që nga mbërritja juaj në strukturën pritëse, do të ndiqeni nga një punonjës social i caktuar. Ky do të jetë personi juaj i referimit. Ai do t'ju japë dokumentacionin e nevojshëm, këshilla si dhe do t'ju orientojë nëse do të jetë e nevojshme drejt shërbimeve të brendshme dhe/ose të jashtme. Ai do të vlerësojë nevojat tuaja gjatë pritjes në qendër si dhe do t'ju informojë mbi kthimin vullnetar në atdhe. Ky person do të hapë dhe do të mbajë një dosje sociale mbi ju. Në rast nevojë, ju mund t'i drejtoheni këtij personi ose njërit prej kolegëve të tij.

I.3. Arsimimi dhe shkollimi i fëmijëve

Në Belgjikë të gjithë fëmijët kanë të drejtë të shkollohen falas duke filluar nga moshën 2 vjeç e gjysmë. Shkollimi i tyre është i detyrueshëm nga moshën 6 deri në 18 vjeç.

Ju jeni përgjegjës për edukimin dhe shkollimin e fëmijëve tuaj. Sidoqoftë struktura pritëse ofrohet t'ju shoqërojë përgjatë gjithë etapave në lidhje me regjistrimin e fëmijëve në shkollë si dhe ecurinë e tyre.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château), gjithashtu edhe në qendër, fëmijët janë nën përgjegjësinë e prindërve.

Fëmijët nën moshën 6 vjeçare duhet që në çdo moment (rast) të jenë nën mbikqyrjen e drejtëpërdrejtë të prindërve, e edhe në sheshet (hapësirat) e vogla të lojrave. Këto sheshe (hapësira) lojrash janë të rezervuara për fëmijët nën moshën 12 vjeçare.

Shpërndarja e parave të xhepit, si dhe qasja në shërbimet e ndryshme duhet të bëhet në prani të njërit nga prindërit. Informohuni pranë shoqëruesit tuaj social.

Lojrat me top dhe përdorimi i i biçikletave bëhen në oborr.

I.4. Ndhimja mjekësore

Ju mund të përfitonit një ndihmë mjekësore të ofruar nga shërbimi mjekësor i strukturës pritëse ose nga mjeku i përgjithshëm tek i cili mbështetet struktura. Ky shërbim ose mjeku do t'ju drejtojnë nëse e nevojshme drejt një mjeku të specializuar. Marrja në ngarkim (për sa i përket anës mjekësore) jashtë strukturës pritëse është e mundur vetëm mbi bazën e një autorizimi të lëshuar nga vetë struktura.

Nëse dëshironi t'i drejtoheni një mjeku tjetër të ndryshëm nga ai i strukturës, duhet t'i përballoni vetë shpenzimet.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château) qasja për shërbimin mjekësor bëhet përmes shqyrtimit nga infermierët. Kontrollat (Konsultimet) e rregullta që kanë të bëjnë me depistimin (ekzaminimin-shfaqjen) e tuberkulozit janë të detyrueshme.

I.5. Ndhimja nga ana psikologjike

Në rast nevoje, do t'ju ofrohet një ndihmë psikologjike. Për më shumë informacione mund t'i drejtoheni ndihmësit social që ju është caktuar, shërbimit mjekësor ose mjekut.

Në Petit Château (Kështjellë e Vogël) , mund të bëni thirrje telefonike në kuadër të procedurës dhe vetëm në këtë kuadër. Drejtohuni tek shoqëruesi i juaj social për më shumë informata.

I.6. Ndhimja juridike

Ju keni të drejtë të përfitoni një ndihmë juridike falas që konsiston në disa këshilla, informacione ose në asistencën nga ana e një avokati. Struktura pritëse do t'ju ndihmojë gjatë këtyre etapave.

I.7. Formimi

Në varësi të mundësive të strukturës pritëse do t'ju ofrohen kurse të ndryshme formimi.

Në Petit Château (Kështjellë e Vogël) mund t'i drejtoheni ekipit BIZZI.

I.8. Aktivitete

Në strukturën pritëse do të organizohen aktivitete të ndryshme dëfrimi (dalje, sporte...) në të cilat jeni të ftuar të merrni pjesë.

Në Petit Château (Kështjellë e Vogël) mund t'i drejtoheni ekipit BIZZI.

I.9. Ndhimja ekonomike e përditshme

Ju keni të drejtë të merrni një ndihmë ekonomike të përditshme sasia e së cilës vendoset sipas rregullores. Kjo ndihmë do t'ju jepet çdo javë.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château), pagesa e mëditjes suaj ditore, shpërndarja e bon-it për shujtë (vakt) për banorët e dhomave që kanë në dispozicion kuzhinë si dhe shtojca e mëditjes suaj ditore për shërbim të bërë ndaj komunitetit, bëhet të martën.

Banorët që kanë arsyetim të vlefshëm mungese mund të paraqiten të nesërmen pasdite – nga dita normale e pagesës. Për të organizuar këtë, mund të paraqiteni tek shoqëruesi (asistenti) juaj .

Ata të cilët nuk kanë arsye të vlefshme për të arsyetuar mungesën e tyre, do marrin të hollat (paratë) e tyre javën që vijon, përderisa shuma e mbetur nuk kalon dy javë. Të hollat (paratë) që nuk janë tërhequr mbrenda dy javësh, nuk paguhet më. Bon-at për shujtë (vakt) mund të tërhiqen vetëm për javën e paraparë, afati dy javor nuk është i mundshëm.

Ditën e nisjes suaj, nëse keni të drejtën e mëditjes apo kompensimit për punët e bëra, këto, sipas rastit, do t'u paguhet nga Qendra, ose nga qendra e re ku juve shkoni.

I.10. Shërbimet komunitare

Në brendësi të qendrës pritëse ose edhe jashtë saj do të keni mundësinë, sipas kushteve, të ushtroni aktivitete të ndryshme në shërbim të komunitetit të banorëve ose në kuadrin e aktiviteteve të organizuara në bashkëpunim me strukturën pritëse. Për organizimin e këtyre aktiviteteve që kontribuojnë në integrimin tuaj në mjedisin përreth do të shpërbleheni me një

vlerë monetare që do t'i shtohet ndihmës ekonomike të përditshme, duke mos kaluar një shifër të përcaktuar.

Në Petit Château (Kështjellë e Vogël), qasja në shërbimet ndaj komunitetit bëhet përmes Zyrës BIZZI dhe kushtëzohet me trajnim-test prej disa orësh (për shkaqe-udhëzime sigurie). U propozohen punë të ndryshme në shërbimet e ndryshme të qendrës. Mund të merrni më së shumti 125€ në muaj përfshi mëditjen.

II. Cilat janë rregullat në lidhje me jetën në komunitet?

Bashkëpunimi juaj është i nevojshëm për të garantuar funksionimin e mirë të strukturës pritëse.

Respekti reciprok i lirive të secilit është një kusht i domosdoshëm për të jetuar mirë sëbashku.

Për këtë, disa rregulla duhet të respektohen nga të gjithë banorët e qendrës.

II.1. Mjedisi i strukturës pritëse dhe përreth

Struktura pritëse ndodhet në një ambient (me fqinjë, lagje, fshatra/qytete) që duhet respektuar.

II.2. Manifestime

Ju kërkohet të mos ndërmerrni manifestime që mund të çrregullojnë funksionimin normal të strukturës pritëse.

II.3. Infrastruktura dhe pajisjet

Në dispozicionin tuaj do të vihen dhoma individuale dhe të përbashkëta sëbashku me pajisje (krevate, pajisje elektroshtëpiake etj.). Ju keni për detyrë të mos i shpërdoroni dhe t'i mirëmbani.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château), me ardhjen tuaj u ipet një dhomë : nuk mund t'a ndërroni.

Nëse u ipet një dry, nuk lejohet zëvendësimi i tij me një dry personal.

Ditën e nisjes suaj kërkohet të lironi dhomën, të pastruar, në ora 10h të mëngjesit.

II.4. Rregullimi/Garancia

Nëse dëmtoni materialin e strukturës pritëse mund t'ju kërkohet që ta rregulloni atë.

Përveç të tjerash mund t'ju kërkohet një garanci përpara dhënies së çelësave të dhomës ose pasi t'ju jetë dhënë material ose pajisje nga struktura.

Kjo garanci do t'ju kthehet në momentin e largimit nga struktura ose pas kthimit të materialit të marrë hua.

II.5. Të mira materiale që ju përkain të tjerëve ose juve

Keni për detyrë të respektoni të mirat materiale që i përkasin të tjerëve. Struktura pritëse nuk mban përgjegjësi në rast dëmtimi të pajisjeve tuaja ose në rast vjedhje.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château), gjërat me vlerë (të holla-para, stoli,..) që gjenden në dhomën tuaj janë nën përgjegjësinë tuaj. Personeli nuk është i autorizuar për ruajtjen-

kujdesin e këtyre gjërave/gjësendeve. Në rast vjedhjeje, keni mundësi të ankoheni pranë policisë.

II.6. Higjiena

Ju kërkohet që të kujdeseni për rregullin dhe pastërtinë e strukturës pritëse. Mirëmbajtja e dhomës është në përgjegjësinë tuaj.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château), mirëmbajtja e dhomë suaj do të kontrollohet rregullisht nga personeli i Qendës.

Nëse dhoma juaj është pa kuzhinë, gatimi nuk lejohet. Vetëm ushqimi që nuk priset, pa skadim afati dhe që nuk kanë nevojë për frigorifer, mund të mbahen në ambalazhet e tyre. Pemët që kanë shenja kalbjeje duhet të hidhen në mbeturina.

Nëse dhoma juaj ka frigorifer, duhet të pëshijellni me celofan ose letër alumini ushqimin që ruani.

II.7. Siguria

Ju kërkohet të respektoni rregullat për parandalimin dhe sigurinë ndaj zjarreve si dhe të mos dëmtoni pajisjet e posaçme kundër zjarrit. Për këtë arsye ndalohet gatimi në dhoma, përveç rasteve kur lejohet posaçërisht nga struktura falë një autorizimi të veçantë..

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château) gatimi lejohet vetëm në dhomat me kuzhinë.

Gjithashtu, mundësia për të ruajtur (mbajtur) bagazhin tuaj në dhomë është e kufizuar. Duhet që të drejtoheni tek shoqëruesi juaj për të diskutuar/shfaqur mundësinë e mbajtjes së bagazhit të tepërt.

Ditën e nisjes suaj, kërkohet nga ju të merrni me vete gjithë bagazhin tuaj. Poqese është e nevojshme bagazhi juaj mund të mbahet vetëm mbrenda 10 ditësh.

Disa gjëra/gjësende janë të ndaluara nëpër dhoma për shkaqe higjienike/pastërtie dhe sigurie (shih shtojcën 1).

II.8. Jeta private dhe ajo familiare

Keni për detyrë të respektoni jetën private dhe familiare të banorëve të tjerë. Të respektoni jetën private të secilit do të thotë të ruash qetësinë brenda strukturës.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château), për respekt ndaj banorëve , kërkohet qetësi nga ora 22h deri në 6h.

Për korrespondencën (postën) tuaj private, por edhe në lidhje me procedurën, mund të tërhiqni postën (letrat), çdo ditë tek recepsioni (hyrja). Do t'ju bëhet me dije (do të informoheni) për ardhjen e postës (letrës) me shfaqjen e numrit të kartelës tuaj elektronike (bexh-it) në hyrje (reception).

Nëse nuk keni telefon, mund të pranoni thirrje telefonike në qendër, përmes ekipit të recepsionit (hyrja). Kjo mundësi u ofrohet nga ora 09h00 deri në 11h15, nga 14h30 deri në ora 17h30 si dhe nga 19h30 deri në ora 22h00, në korridorin e hyrjes (reception).

II.9. Vizitorët

Ju mund të keni vizita sipas rregullores së parashikuar nga struktura pritëse.

Në Petit Château (Kështjella e Vogël), vetëm banorët që jetojnë me familje në qendër mund të kenë mysafir nga jashtë. Duhet të kenë/marrin lejen nga shoqëruesi i tyre përkatës social. Afër hyrjes (receptioni-t) – por jashtë qendrës, një shesh/hapësirë është e rezervuar për vizitorët/mysafirët që nuk kanë të drejtë hyrjeje.

Të njëjtën mënyrë, vetëm banorët që jetojnë në familje, mund të mirëpresin banorë të tjerë (të qendrës) në hapësirën ku jetojnë (private)...Personave të izoluar (të vetëm, beqar) nuk u lejohet të mikpritja e banorëve tjerë nëpër dhomat e tyre.

Vizitat e lejuara (me leje) mund të jenë në mes orës 9h dhe 21h.

II.10. Prani të rregullt në strukturën pritëse

Vendi juaj në strukturë mund të ruhet vetëm nëse ju jeni të pranishëm rregullisht në të. Nëse paralajmëroni në kohë strukturën, mund të mungoni deri në 10 net në muaj. Në rast të kundërt krevati dhe vendi juaj do t'i kalojnë diku tjetër. Kjo gjë do të ndodhë edhe në rast se mungoni për më shumë se 3 net rresht pa paralajmëruar. Dhoma do të zbrazet nga efektet tuaja personale dhe ju duhet të paraqiteni përsëri nga e para për të marrë një dhomë të re.

Për këtë arsye prania juaj do të verifikohet rregullisht.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château), qendra është e hapur nga ora 6h e mëngjesit deri në 2h të mëngjesit. Nëse nuk jeni në qendër nga ora 2h deri në orën 6h, do të regjistroheni sikur të keni kaluar natën jashtë.

Me ardhjen tuaj një kartelë elektronike (bexh elektronik) u është dhënë. Ky bexh (kartelë elektronike) duhet të përdoret çdo herë që dilni apo hyni, duke e vënë atë pranë derës barrierë të hyrjes/daljes. Është vetanake (personale) prandaj nuk mund t'i ipet një personi tjetër.

Kërkojmë nga ju që t'a keni gjithnjë me vete e t'a paraqisni kur u kërkohet nga anëtarët e personelit. Është e nevojshme të paraqitet për qasje në shërbimet e ndryshme të qendrës.

Për të n'a bërë me dije mungesën tuaj për 3 netë reshtazi, kërkojmë që me daljen tuaj të informoni receptionin dhe të dorëzoni kartelën elektronike (bexh-in)

Çdo keqpërdorim i kartelës elektronike dënohet.

Nëse humbni kartelën (bexhin) apo nëse nuk funksionon, duhej që sa më shpejtë të drejtoheni tek koordinimi ose, jashtë orarit punues të këtij shërbimi, në reception (hyrje). Zëvendësimi i saj është në ngarkesë tuajën.

II.11. Detyra e informimit

Keni për detyrë të informoni punonjësën social mbi ecurinë e dosjes tuaj administrative.

II.12. Takime jashtë qendrës

Keni për detyrë të paraqiteni në takimet mjekësore ose psikologjike që janë lënë jashtë strukturës së qendrës pritëse dhe që janë prenotuar nga e njëjta qendër.

Në Petit Château (Kështjellë e Vogël), kërkojmë gjithashtu të respektoni takimet e ndryshme në qendër. Nëse mungoni në një takim të marrur në bashkëpunim me qendrën, një dëmshpërblim mund t'u kërkohet për shpenzimet e shkaktuara.

Për të ruajtur qetësinë e secilit dhe për të jetuar në një ambjent të pëlqyeshëm dhe të sigurt, duhet të respektohen një sërë rregullash brenda strukturës pritëse.

II. 13. Shërbime me pagëse të jashtme

Të gjitha shërbimet me pagesë të kryera jashtë qendrës pa paralajmëruar më parë strukturën ngelen në ngarkimin tuaj.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château), në kuadër të procedurës, të konsultimeve mjekësore, të studimeve, është e mundur me disa kushte të keni bileta për transportin publik. Sipas rastit, drejtohuni tek shoqëruesi përkatës social në shërbimin mjekësor ose në/te BIZZI.

Por, në rast të përdorimit të transporteve publike, taksi, apo ambulancë (ndihmë e shpejtë), shpenzimet janë në ngarkesë tuajën e Qendra do marrë masat që t'u kthehen këto shpenzime.

II.14. Dhunë fizike ose verbale

Ndalohet rreptësisht ushtrimi i dhunës fizike ose verbale ndaj kujtdo. Të gjitha dëmtimet me dashje ndaj sendeve ose personave mund të kenë si pasojë denoncimin pranë autoriteteve të posaçme (p.sh. në polici,...).

II.15. Racizmi dhe diskriminimi

Ndalohet përdorimi dhe/ose inkurajimi i sjelljeve me sfond racist ose diskriminues. Të gjitha rastet e racizmit do të ndiqen penalisht nga legjislacioni në lidhje me diskriminimin racial.

Në lidhje me këtë, duhet thënë se Belgjika është një vend që karakterizohet nga toleranca dhe liria dhe që dënon të gjitha format e diskriminimit dhe cilëson barazinë midis burrave dhe grave si një prioritet. Ne ju garantojmë respektimin e këtyre vlerave dhe ju kërkujmë t'i respektoni edhe ju në jetën tuaj të përditshme.

II.16. Drogat dhe alkoli

Mbajtja dhe konsumimi i alkolit dhe drogave në strukturën pritëse – përfshi këtu edhe hashashin dhe cannabis sativën është rreptësisht i ndaluar. Përveç kësaj, ndalohen të gjitha sjelljet problematike që vijnë si pasojë e përdorimit të alkolit, ilaçeve ose të substancave të tjera të ndaluara.

II.17. Duhani

Ndalohet rreptësisht pirja e duhanit në brendësi të ndërtesave të strukturës pritëse, përveçse në vende të posaçme që janë të treguara, gjithnjë në rast se ato ekzistojnë.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château) vetëm një lokal është i rezervuar për këtë çështje (lokali 44)

II.18. Objekte të rrezikshme

Ndalohet mbajtja e objekteve të rrezikshme që mund të paraqesin rrezik për banorët ose personelin ose që mund të dëmtojnë infrastrukturën ose lokalet e strukturës pritëse.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château), dhoma juaj (përfshi dollapi), do të kontrollohet sipas një kodi mirësjelljeje nga dy anëtarë të personelit për të verifikuar respektimin e rregullores, sigurohet çështja e sigurimit dhe higjienës/pastërtisë në qendër. Nëse gjëra/gjësunde të ndaluara gjinden ato do të mirren. Lista e gjërave të ndaluara është në Shtojcën 1. Nëse mungoni në atë moment, do të informoheni se dhoma juaj është kontrolluar.

II.19. Kafshët shtëpiake

Kafshët shtëpiake ndalohen në strukturat pritëse.

III. Ndëshkime dhe marrje masash

Në rast mangësirash të mëdha në respektimin e rregullores dhe për të siguruar rregullin, sigurinë dhe qetësinë në qendrën pritëse do të merren masa të rrepta ndaj banorëve.

Ndëshkimet

Ju mund të ndëshkoheni në rast mangësirash të mëdha e të rënda ndaj rregullores së brendshme të strukturës. Ndëshkimi do të ndryshojë në varësi të natyrës dhe masës së mangësisë si dhe të rrethanave konkrete në të cilat ju kryet mangësinë.

Të gjithë pjesëtarët e personelit kanë për detyrë të ruajnë respektimin e rregullores. Për të gjitha mangësitë e konstatuara, drejtoria do të kujdeset që versioni juaj të dëgjohet plotësisht në mënyrë që të merret një vendim i paanshëm.

Nëse do të jetë e nevojshme struktura do të marrë masa në varësi të fakteve të kryera dhe do të motivojë vendimin e saj. Ky vendim do t'ju bëhet i ditur me shkrim dhe ju duhet të firmosni në momentin e marrjes së letrës me vendimin.

Këto janë ndëshkimet e mundshme :

1. lajmërim formal me vërejtje në dosjen tuaj sociale ;
2. përjashtim i përkohshëm nga aktivitetet e organizuara nga struktura pritëse;
3. përjashtim i përkohshëm nga mundësia për të ushtruar punë të paguara brenda strukturës pritëse;
4. kufizim të hyrjeve në disa shërbime ;
5. detyrim për të kryer disa detyra të tjera dhe moskryerja ose kryerja jo e plotë e tyre mund të konsiderohet si një mangësi e re ;
6. transferim në një strukturë tjetër.
7. Përjashtimi i përkohshëm nga rrjeti i mikpritjes

Marrja e masave

Në rast se siguria dhe qetësia e strukturës vihen në rrezik, drejtori ose përgjegjësi mund të marrin masa për të garantuar funksionimin e mirë të qendrës dhe të jetës në komunitet.

Nëse kjo masë merret ndaj një ose më shumë banorëve atëherë do të shkruhet një dokument i motivuar i cili do t'ju përcillet edhe banorëve të përzierë në këtë fakt. Nëse bëhet fjalë për një masë që u drejtohet të gjithë banorëve atëherë lajmërimi do të kryhet përmes afisheve të dukshme në të gjithë strukturën.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château), nëse duhet të largoheni/dilni nga Qendra për shkak të një dënimi disiplinor apo për shkak të një mase për mbajtjen e rendit, duhet të largoheni/dilni nga Qendra sapo të jeni vënë në dijeni të dënimit apo të masës së marrë. Qendra do të kujdeset që hapat e nevojshëm për daljen tuaj (bagazh, mëditjen, dorëzimin e dosjes suaj sociale apo mjekësore, ...) të ndërmerren.

IV. Cilat janë mënyrat e ankesave që keni në dispozicion?

Kundërshtimi i një ndëshkimi

Ju keni të drejtë të kundërshtoni një ndëshkim (atë nr. 4, 5 e 6). Ky kundërshtim duhet t'i dërgohet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjensisë [ose personit të caktuar nga Agjensia] me anë të një letre brenda pesë ditësh duke filluar nga data e vendimit që është marrë ndaj jush. Kundërshtimi duhet bërë në një prej gjuhëve zyrtare në Belgjikë ose në anglisht. Kundërshtimi nuk anulon efektin e ndëshkimit i cili duhet të kryhet në pritje të marrjes së një vendimi përfundimtar pas kundërshtimit.

Ankesat

Nëse dëshironi të ankoheni mbi kushtet e jetesës në strukturën pritëse ose mbi aplikimin e rregullores së brendshme, mund t'i drejtoheni drejtorit ose përgjegjësit të strukturës pritëse i cili do të trajtojë ankesën tuaj brenda shtatë ditësh.

Në Kështjellën e Vogël (Petit Château), mund të drejtoheni tek punonjësit social për këto çështje/gjëra.

E nëse hasni në vështirësi me banorët tjerë, mund të tërheqni vëmendjen e anëtarëve të personelit (shoqëruesit social, anëtarët e recepsionit/hyrjes...)

Informacione të mëtejshme?














- ▶ Nëse keni akoma pyetje në lidhje me këtë rregullore të brendshme ose mbi të drejtat tuaja në kuadrin e pritjes në një strukturë komunitare, mund t'i drejtoheni punonjësit social.




Unë i nënshkruari, _____, konfirmoj se jam informuar dhe jam pajisur me një kopjo të kësaj rregulloreje të brendshme e cila më është shpjeguar në një gjuhë që unë jam në gjendje të kuptoj.

Rregulli specifik për Klein Kasteeltje (kështjellën e vogël)






Shtesa 1 – Gjërat e ndaluara

NDALOHEN





	Armët ****	*Shih listën në shtesë për më shumë shpjegim.
	Materjalet e kuzhinës	Nuk mund të merrni gotat , pjatat, filxhanët , lugët ,pirunjt, jashtë kuzhinës.
	Kabëll shtesë	Përfshi dhe shtesat tip “domino”
	Kafshët shtëpiake	
	Droga	Si ajo e lehtë e ajo e rëndë.
	Cigarja / duhani	Është i lejuar vetëm jashtë ose në vëndet e caktuara.
	Produkte të rrezikshme	
	Hekuri për hekurosje	
	TV	Dvd janë të lejura
	Për të zier ujë	
	Ndezja e zgjarrit	Përfshi qirinjtë, aromat, shkopinj me tym,
	Pije alkoholike	
	Mjete pune (jo elektrike))	


	Biçikleta (për të rritur)	
	Pasqyra për tu parë	Pasqyra Spiegel = maksimum 200 cm ² , me kornizë.
	Kompjuter	Laptopi është i lejuar .



E LIMITUAR

	Bagazhi: maksimum 1 m ³ për person	=~ 2 valixhe (poshtë krevatit) + 1 çantë udhëtimi (në dollap)
	Aparate elektrike: maksimum 300 W	
	Lodra: maksimum 3 për fëmijë	
	Tapet për tu falur: 1 për person	Vendose në dollap
	Biçikleta për fëmijë: 1 për fëmijë -12 vjeç	Jo në dhomat e blokeve BCD dhe dhomat mjeksore

PAS PRANIMIT

	Tapete	Tapete që janë rezistues nga zjarri, janë të lejuara
	Posters, foto, afishe.....	Të vendosura mirë dhe të mos ketë rrezik zjarri
	Dekoracione për festë	Të vendosura mirë dhe të mos ketë rrezik zjarri
	TV	Në dhomat familiare BCD dhe dhomat mjeksore B

	Aparat për të zier ujë	Vetëm në studio bllokun EF
---	------------------------	----------------------------

vetëm “Kështjellën e vogel”		
	Mobilje, mbulesa dhe materiale kuzhine.	Nuk lejohen materiale guzhine të marra nga guzhina kryesore, vetëm mbulesa-RF.
	TV	Në studio të EF dhe dhomat e mjekimit F

SHTESË – ANNEXE – ANNEX

ARMËT

Janë të ndaluara:

- Armët e bëra për përdorim luftarak, përfshi këtu armët automatike.
- Thikat e palosura ose me çelës(thikat te mprehta)
- Armët e krijuara per perdorim ushtarak dhe armet
- thika te palosura dhe thikat e llojeve te ndyshme;
- te gjitha llojet e shkopinjve;
- municionet.